



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË PRIMLJENO DANA: 29.06.2026			
NR. DOKUMENTIT	NR. TASHKIMIT OP. REGJISTRIMIT	NR. LINDËS SH. FREDMETA	SHTOJCA SHLOQ
05-453101-	28924		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

THIRRJE PUBLIKE PËR ANËTARËSIM NË ASAMBLENË E KËSHILLIT LOKAL RINOR TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Në bazë të nenit 15 të Ligjit Nr. 08/L-264 për Rininë, Komuna e Lipjanit shpall Thirrje Publike për aplikim për anëtarësim në Asamblesë e Këshillit Lokal Rinor të Komunës së Lipjanit.

Asambleja e Këshillit Lokal Rinor të Komunës së Lipjanit është asamble e organizatave rinore, organizatave për të rinjtë, këshillave të nxënësve të shkollave të mesme të larta dhe forumeve rinore të partive politike, e cila ka për detyrë themelimin e Këshillit Lokal Rinor të Komunës së Lipjanit dhe miratimin e aktit të themelimit të tij.

Drejtoria Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Lipjanit ka për detyrë pranimin e aplikimeve dhe formimin e komisionit përgjegjës për shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë thirrje publike.

Të gjitha organizatat rinore, organizatat për të rinjtë, këshillat e nxënësve të shkollave të mesme të larta dhe forumet rinore të partive politike, të cilat i përmbushin kriteret e nenit 23 të Rregullores (MKRS) Nr. 09/2024 për Procedurat e Themelimit, Funkcionimit dhe Punës së Këshillave Rinorë, bëhen pjesë e Asamblesë së Këshillit Lokal Rinor.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. **Letër motivuese**, e cila specifikon përvojën, qëllimet e strukturës aplikuese për të qenë pjesë e Asamblesë, si dhe të dhënat bazike të përfaqësuesit të deleguar të moshës rinore.
2. **Portfolio** e strukturës aplikuese.
3. **Certifikata e regjistrimit** (për OJQ-të), ose njohja zyrtare nga shkolla apo partia politike (për këshillat e nxënësve dhe forumet rinore të partive politike).
4. **CV-ja** e përfaqësuesit/es së deleguar nga struktura aplikuese për të qenë anëtar/e i/e Asamblesë.
5. **Certifikata e gjendjes penale** e përfaqësuesit/es.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Aplikimet, së bashku me dokumentacionin e kërkuar, dorëzohen në adresën elektronike të Drejtorisë Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Lipjanit:

E-mail: astrit.buja@rks-gov.net

Afati për aplikim është nga 29.06.2026 deri më 17.07.2026, në ora 16:00. Për informata shtesë, të interesuarit mund të kontaktojnë Drejtorinë Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Lipjanit.

Astrit Buja Drejtor i DKRS-së:

